

10 korrik 2012, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Auditori i Përgjithshëm i konfirmon shqetësimet e shoqërisë civile për qeverisje jo të mirë në komunën e Prizrenit

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm e Republikës së Kosovës para disa ditësh ka publikuar raportin vjetor 2011 të auditimit për komunën e Prizrenit. Jemi thellësisht të shqetësuar se të gjeturat e këtij raporti dëshmojnë për paaftësinë e komunës së Prizrenit për qeverisje të mirë dhe transparente kur bëhet fjalë për parane publike. Edhe një herë, raporti i vjetor i auditimit ka nxjerrë në pah shumë aspekte të qeverisjes së keqe, të cilat shoqëria civile është duke i artikuluar tashmë një kohë të gjatë.

Auditori i Përgjithshëm ka konstatuar disa segmente të qeverisjes së dobët në komunën e Prizrenit. Sipas Auditorit, komuna nuk ka arritur të ndërtojë një strukturë të mirë të qeverisjes dhe se menaxhmenti i komunës duhet të zhvilloj një qëndrim më pozitiv ndaj kontrolleve të brendshme të organizatës. Një vlerësim i përgjithshëm është se për vitin 2010 ishin dhënë 10 rekomandime nga Auditori, ku komuna ka adresuar adresuar vetëm dy rekomandime plotësisht, ndërsa tetë nuk janë adresuar fare.

Për më tepër, Auditori konstaton se komuna nuk ka arritur ta harmonizoj plotësisht buxhetin me dinamikën e shpenzimeve në periudha kohore, si dhe nuk ka vendosur mekanizmat e duhur të kontrollit mbi të hyrat vetjake. Në 60 mostra të testuara nga Auditori, që mbulojnë mbi 6 milion euro të pagesave të shpenzimeve përmes procedurave të prokurimit, është vërejtur se në 17 mostra komuna ka ndërmarrë procedurat e prokurimit të cilat nuk janë në pajtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik. Zhvillimi i procedurave të prokurimit, pasi aktivitetet të jenë kryer, është një praktikë që nuk njihet nga ligji dhe si e tillë nuk duhet të ndodhë. Gjithashtu, kryerja e pagesave pa arritjen e objektivave të kontratës, flet për një performancë të keqe financiare, sipas raportit të Auditorit për komunën e Prizrenit.

EC Ma Ndryshe shpreh shqetësimin se komuna e Prizrenit nuk ka ndonjë rregullore të veçantë për qëllimet dhe procedurat e dhënies së subvencioneve. Mungesa e një rregullore të tillë, sipas raportit të Auditorit rrit rrezikun që paraja publike të mos shpenzohet për qëllimet e duhura. Ndërsa, tek menaxhimi financiar, e metë tjetër është se komuna nuk i ka menaxhuar pasuritë e saj në pajtim me Udhëzimin administrativ nr.21/2009 për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive qeveritare. Prandaj, konkluzioni i Auditorit është se komuna nuk ka arrit të promovoj dhe zbatoj kërkesat e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike (KBFP). Një tjetër segment problematik, e që monitorohet edhe nga projekti i EC Ma Ndryshe për transparencën komunale, është auditimi i brendshëm, ku trajtimi i rekomandimeve të auditimit nuk është i kënaqshëm. Raporti i Auditorit konstaton se ndryshimet nga viti i kaluar janë gati të pa dukshme

Në përmbledhje, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për komunën e Prizrenit për vitin 2011 ka nxjerr këto përfundime:

- Komuna nuk ka arrit të ndërtoj një strukturë të mirë të qeverisjes,
- Menaxhmenti i komunës duhet të zhvilloj një qëndrim më pozitiv ndaj kontrolleve të brendshme të organizatës,
- Monitorimi i kontratave është i mangët dhe i pa mjaftueshëm,

- Obligimet ndaj raportimeve të rregullta dhe të besueshme, duhet të jenë pjesë e përditshme e aktiviteteve për të gjithë,
- Aftësitë e stafit dhe përvoja e tyre duhet të jenë pikënisje për ndarjen e detyrave dhe dhënien e përgjegjësive,
- Trajnimet e rregullta dhe promovimet në baza të performancës, po ashtu duhet të praktikohen.

Si përfundim, EC Ma Ndryshe i apelon ekzekutivit të komunës së Prizrenit, me theks të veçantë kryetarit të komunës që të zbatojë me përpikmëri rekomandimet që dalin nga raporti i auditimit për vitin 2011, e që janë në përputhje edhe me vërejtjen dhe rekomandimet e organizatave të shoqërisë civile që e monitorojnë punën e komunës së Prizrenit. Menaxhimi i parasë publike është elementi më i rëndësishëm i qeverisjes së mirë dhe demokratike. Ndërsa, vendimmarrja transparente është parakusht i domosdoshëm për menaxhim të mirë të parasë publike dhe luftim të aferave korruptive në qeverisjen lokale. EC Ma Ndryshe do të vazhdojë të monitorojë nga afër transparencën e komunës së Prizrenit (me fokus në ekzekutivin komunal), pasi që transparenca qëndron në thelb të qeverisjes së mirë dhe menaxhimi të drejtë të parasë publike.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe prej muajit korrik përmes web-faqes së projektit, ku të gjeturat do të postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në web-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju falemnderit për bashkëpunimin tuaj,

Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv
 OJQ EC Ma Ndryshe
 Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
 Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
 +381 38 522 199 & +386 49 116 448

Projekti “Transparenca on-line e komunës së Prizrenit” mbështetet financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

SOROS

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
 Kosovo Foundation for Open Society
 Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo